



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.10.2024, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K, e dt.10.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Rrugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 07.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 07.10.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K, me dt.10.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e

prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit 1: Ju njoftojmë se kërkesa për damperët ka qenë e qartë për të gjithë ofertuesit në këtë tender, ku në afatin e paraparë për sqarime të dosjes së tenderit nuk është kërkuar sqarim, mirëpo në këtë fazë ju pretendoni se kërkesa është e pa qartë.

Pas shqyrtimit të këtij pretendimi ju ri-theksojmë se kërkesa për këtë pikë ka qenë e qartë dhe në këtë pikë ju nuk keni ofruar dëshmi se posedoni Dumper me peshë minimum 30 ton dhe të cilat posedojnë certifikatën e regjistrimit të automjetit me afat valid, ku keni ofruar dëshmi se posedoni 4 Dumper të dëshmuar me DUD, si dhe shtesë keni ofruar 4 Kamiona kiper me certifikata të regjistrimit të automjetit të cilët nuk plotësojnë kërkesën për këtë pikë, kjo duke u bazuar edhe në Vendimin e OSHP-ës nr. 2023/0560 dt.08.12.2023 (faqe 5 dhe 6) dhe ekspertës së saj ku kanë konstatuar se nuk mund të pranohen kamionët kiper si kamion Dumper. Andaj konsiderojmë se kjo qeshje është e gjykuar tash më nga OSHP dhe në këtë pikë nuk plotësohet kriteri i kërkuar në DT, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

Sa i përket pretendimit 2 dhe pretendimi 3 të kërkesës për ri-shqyrtim ju njoftojmë si në vijim: dëshmitë e kërkuara me sqarime shtesë nuk janë ofruar nga ana juaj.

1. Dokumenti ku dëshmohet afati valid i vinçit me tableta e regjistrimit 05-812-GC pronë e NNP “Sigma”, nuk është dëshmuar as në dokumentat e aplikimit për tender as në dokumentet e dorëzuara pas kërkesës për sqarime shtesë. Një dokument i tillë nga ju, është ofruar vetëm në kërkesën për ri-shqyrtim të parashtrua me datë 10.10.2024 pasi që jeni eliminuar, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;
2. Dokumenti ku dëshmohet pesha e frezës që montohet në bager deri 2t nuk është dëshmuar as në dokumentat e aplikimit për tender as në dokumentet e dorëzuara pas kërkesës për sqarime shtesë. Një dokument i tillë nga ju, është ofruar vetëm në kërkesën për ri-shqyrtim të parashtrua me datë 10.10.2024 pasi që jeni eliminuar, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

- Pas kërkit të sqarimeve shtesë ju keni shënuar në pikën 12 të listës së pajisjeve se keni këtë dëshmi: Luge Hidraulike Ripper (Grremç) I blere me fature dhe foto ne pronësi te Viktory Com

Ndërsa nga ju është kërkuar në sqarime shtesë: Kontrata e shitblerjes me person fizik me Mentor Delija – ku mungonte dokumenti qe tregon specifikimin teknik për peshën dhe për ripper.

- Nga kërkitimi i dokumenteve të dorëzuara me sqarime shtesë nuk është gjetur as njëra nga dëshmitë e lart-cekura. Pra, ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni kërkesën për këtë pikë, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

15.10.2024
Komuna e Gjakovës

- Ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni kërkesën për pikën 22 të listës së pajisjeve përkatësisht për Cilindër me rrota hekuri me vibrim, min 8.0t, edhe pse ju është kërkuar me sqarime shtesë, sërish nuk është dëshmuar se a është me rrota të hekurit dhe me vibrim, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;
- Ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni kërkesën për pikën 23 të listës së pajisjeve përkatësisht për pajisjen që keni ofruar Kamion DAF 450 me tabelat 05-698-AJ ku nuk është dëshmuar që shërben për spërkatje të bitumit dhe emulsionit, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;
- Sa i përket shtimit material siç edhe ju e keni potencuar një veprim i tillë nuk lejohet andaj dokumentet që i konsiderojmë si shtim material duke nisur nga lista e pajisjeve dhe dokumentet tjera ju kemi potencuar në letrën standarde që keni pranuar për eliminim, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
